



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V

Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Mbledhja nr. 56.

Prishtinë, më 19.10.2016 në orën 11:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala C-203

PROCESVERBAL

I mbledhjes së Komisionit për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim

Në mbledhje morën pjesë: Agim Çeku, Mufera Shinik, Kimete Bytyqi, Fisnik Ismaili, Ali Berisha, Cerim Bajrami, Veton Berisha dhe Danush Ademi .

Munguan: Jasmina Zhivković, Milka Vuletić, Sasha Milosavljević , Slavko Simić.

Pjesëmarrës të tjerë në mbledhje : Senad Karaahmetović përfaqësues i OSBE-së, Artan Murati përfaqësues i KDI-së, Zijush Ahmeti -konsulltant i Sekretariatit të KKK dhe Celal Iliaz- Drejtorja për Media dhe Marrëdhënie me Publikun.

Stafi mbështetës i Komisionit: Natasha Prica-Tishma dhe Drita Çarkaxhiu.

Mbledhjen e kryesoi: **Agim Çeku**, nënkryetar i Komisionit.

Për këtë mbledhje u propozua, ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur, me datë 19.09.2016;
3. Inicimi i Komisionit për nismën legjislative për plotësim dhe ndryshim të Ligjit nr.03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës;
4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-101 për performancën energjetike në ndërtesa, me amendamentet e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;
5. Të ndryshme.

1. Miratimi i rendit të ditës;

Zëvendëskryetari, hodhi në votim rendin e ditës dhe pasi nuk pat propozime konkrete, konsideron se miratohet rendi i ditës, pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së mbajtur më 19.09.2016;

Zëvendëskryetari, konstatoi se Komisioni miratoi procesverbalin e mbledhjes së mbajtura më 19.09.2016, pa vërejtje.

3. Inicimi i Komisionit për nismën legislative për plotësim dhe ndryshim të Ligjit nr.03/L-064 për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës;

Agim Çeku – nënkryetar i parë, theksoi se kjo pikë e rendit të ditë është caktuar me propozim të deputetit Veton Berisha, me kërkesë që të inicohet nisma legislative për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës. Sipas qëndrimit të tij, del se me këtë ligj janë përfshirë festat e të gjitha komuniteteve joshumicë, përveqë komunitetit egjiptian. Dhe ky është qëllimi për plotësimin e të njëjtit me arsye të shtohet në 'Ditët memoriale' 24 Qershori, ditë e egjiptianëve.

Në fjalën e tij thase se festat e reja zyrtare mund të përcaktohen me plotësimin dhe ndryshimin e Ligjit për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Kjo çështje do të procedohet në bazë të nenit 53 të Rregullorës së Kuvendit të Republikës së Kosovës, dhe të drejtë për propozim të Projektligjeve në Kuvend mund të paraqes Presidenti i Republikës së Kosovës, Qeveria, deputetët e Kuvendit, komisionet parlamentare, grupi parlamentar dhe së paku 6 deputetë.

Në kuadër të Strategjisë Legislative janë dhënë propozime të fillojë ndryshimi i këtij Ligji dhe kjo rezulton se ka interesim për plotësimin e të njëjtit. Ndërkaq, Kosova është një ndër vendet sekulare dhe Kushtetuese ku janë përfshirë shumë festa zyrtare në krahasim me vendet të tjera në rajon, si p.sh me këtë ligj është shënuar si festë zyrtare Dita e Evropës.

Fjalën për shqyrtim të hollësishëm, ia dha Veton Berishës.

Veton Berisha, theksiu se Ligji për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës ka bazueshmëri në Kushtetutë dhe Rregulloren e Kuvendit të Republikës së Kosovës dhe se në bazë të kërkesave të komunitetit egjiptian është i domosdoshëm plotësimi i të njëjtit me arsye që festa në ditët memoriale të jenë në përputhshmëri me dispozitat e këtij Ligji.

Në mes tjerash dha sqarime se komuniteti egjiptian ka origjinë dhe identitet të vetin, njihet si komunitet që tradicionalisht jeton dhe vepron në Republikën e Kosovës. Sa i përket çështjes së kulturës dhe traditave të qytetarëve të Kosovës dhe shtetasve të saj, ekziston pabarazi në raport me përmbushjen e obligimeve që dalin nga Ligji për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës. E gjithë kjo dëshmon se me këtë Ligj nuk janë përfshirë festa për komunitetin egjiptian, siq i kanë komunitetet tjera joshumicë.

Ai kërkoi të marrë përkrahjen e plotë të Komisionit dhe të procedohet nisma për hartimin e Projektligjit për Festat Zyrtare, gjegjësisht të amendamentohet neni 5.5 konformë ligjit, me qëllim që të shtohet në 'Ditën Memoriale' 24 Qershori, dita e egjiptianëve.

Nënkryetari, kërkoi nga kolegu të ofrojë sqarime para komisionit lidhur me rrjedhën e caktimit të festës së komunitetit egjiptian, pikërisht shënimi i datës 24 Qershorit.

Veton Berisha, theksoi se me Kushtetutë dhe Ligjin për mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre në Republikën e Kosovës, iu garantohen të drejtat e barabarta komunitetit egjiptian siq i kanë edhe komunitetet tjera joshumicë.

Ai diskutoi se është mbajtur Kongresi i parë me datë 24 qershor 2010, në qytetin e Ohrit në Maqedoni, ku është arritur marrëveshja e përfaqësimit të komunitetit egjiptian në rajonin e Ballkanit. Gjegjësisht, kjo datë është shënuar në bazë të mekanizmave politikë dhe bashkëpunimit të shoqëritë civile, në nivel Ballkanik.

Nënkryetari, theksoi se është legjitime kërkesa për inicimin e nismës për ndryshimin e Ligjit për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës, qëllimi i të cilit është të amandamentohet nent 5.5, ku në ‘Ditët memoriale’ do të shtohet 24 qershori, dita e egjiptianëve.

Kërkesa e tij ishte që të përcaktohen anëtarët e Komisioni lidhur me procedurat e inicimit legjislativ të plotësimit ndryshimit të këtij ligji, nën një Komisioni të procedojë vendimin në Kryesi për nismën legislative të hartimit të Projektligjit për ndryshimet dhe plotësimet të Ligjit për festat zyrtare në Republikën e Kosovës, me të drejtë që Qeveria në afat prej një muaji të kthejë mendimin. Si mundësi e dytë, Kuvendi të ngarkojë Qeverinë e Republikës së Kosovës të fillojë nismën e hartimit të Projektligjit për Festat Zyrtare në Republikën e Kosovës.

Për marrjen e vendimit për këtë çështje, hapi debat.

Veton Berisha, tha se pasjtohet me dy propozimet e latëcekura nga se kan bazueshmëri ligjore. Me rëndësi është që Komisioni të marr iniciativën për nismën legislative të hartimit të Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës, me mundësi që i njëjti të procedohet në Kryesinë e Republikës së Kosovës.

Ali Berisha, theksoi se komuniteti egjiptian me shekuj jeton dhe vepron në territorin e Kosovës, fakt ky që iu mundëson të gëzojnë të drejtat siq i kan edhe komunitetet tjera joshumicë. Gjegjësisht, komuniteti në fjalë e feston këtë ditë me vite andaj kjo kërkesë duhet të trajtohet me kujdes dhe të bëhet legjimime.

Ai ka përmend propozimet dhe mënyrën aktuale për nismën legislative, e cila është rrugë e domosdoshme që me ligj të zyrtarizohet festa për komunitetin egjiptian. Pajtohet me propozimin e parë, që vendimi për nismën legislative të ligjit, të procedohet në Kryesi.

Kimete Bytyqi, në kuadër të dy propozimeve, fillimisht Komisioni të procedojë nismën legislative për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Festat Zyrtare në Kryesinë e Republikës së Kosovës dhe si propozim i dytë të procedohet hartimi i Projektligjit në Qeveri. Sipas qëndrimit të saj dhe të GP të LDK-së, dha propozim që rekomandimi të procedohet në Kryesinë e Republikës së Kosovës.

Danush Ademi, theksoi se deri më sot nuk është propozuar në strategjin legislative ndryshim plotësimi i Ligjit për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës edhe përkundër kërkesave të shumta. Përveq tjerash, tha se në Kosovë festohen ditët të cilat nuk jan përfshirë me këtë Ligj, si psh festa e hellunit etj.

Në këtë ligj, thuhet se ditët tjera memoriale përcaktohen nga Qeveria e Republikës së Kosovës në konsultim me komunitetin serb dhe kjo për mua është e pakuptim . Në kuadër të këtyre arsyeve është e drejtë legjitime që festat zyrtare të definohen me ligjet e Kosovës. Është i mendimit të procedohet hartimi i Projektligjit për festat Zyrtare të Republikës së Kosovës, me ndryshim që në ditët memoriale të shtohet festa për komunitetin egjiptian.

Qerim Bajrami, Duke marrë parasysh domosdoshmërinë dhe praktikën e mira të disa vendeve në rajon duhet ti japim mundësi që me ligj të përkrahen festa e komunitetit egjiptian njëjt siq festohen ditët memoriale të komuniteteve tjera joshumicë. Ai ishte i të njëjtit mendim që kjo çështje të procedohet në Kryesinë e Republikës së Kosovës.

Nënkryetari, konsideron se anëtarët e komisionit u pajtuan me iniciativën për nismën legislative për ndryshim dhe plotësim të ligjit për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Në kuadër të hartimit të Projektligjit, propozoi të formohet Grupi punues në këtë këtë përbërje: kryesues- Veton Berisha dhe anëtarët: Çerim Bajrami e Kimete Bytyqi.

Nënkryerati, konstatoi se Komisioni për të Drejtat dhe Interesat e Komuniteteve dhe Kthim pajtohet në formë unanime që vendimi të procedohet në Kryesi për nismën legislative për ndryshim dhe plotësim të Ligjit për Festat Zyrtare të Republikës së Kosovës, dhe nxorri këtë:

Përfundim

Në bazë të nenit 79 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe nenit 53 të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, Komisioni për të drejtat, për interesat e komuniteteve dhe për kthim, konform Ligjit për nismën legislative, mori këtë:

VENDIM

1. Komisioni për të drejtat, për interesat e komuniteteve dhe për kthim të hartojë Projekt ligjin për ndryshimet dhe plotësimet e Ligjit nr. 03/L-064 për festat zyrtare, propozuar nga deputeti Veton Berisha;
2. Të formohet Grupi punues në këtë përbërje: Veton Berisha – kryesues dhe Çerim Bajrami e Kimete Bytyqi - si bartës të procesit të hartimit të Projekt ligjit,
3. Anëtarët e Komisionit, në bazë të interesimit, mund t'i bashkëngjiten Grupit punues gjatë punës së tij,
4. Grupi punues, në bashkëpunim me Njësinë për koordinimin e komisioneve, të hartojë Planin e veprimit dhe mëpastaj të përpiloj Raportin e shkruar, për shqyrtim dhe miratim në Komision,
5. Shpenzimet e Grupit punues në realizimin e këtij Vendimi mbulohen nga buxheti i Komisionit, gjegjësisht nga buxheti i Kuvendit.

4. Shqyrtimi i Projektligjit nr. 05/L-101 për performancën energjetike në ndërtesa, me amendamentet e Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor;

Nënkryetari, paraqiti për shqyrtim Projektligjin Nr . 05/L-101 për performancën energjetike në ndërtesa me raport amendamente të Komisionit Funksional dhe vlerësoi se nuk ka vërejtje apo sugjerime nga anëtarët e Komisionit.

Me që nuk pati vërejtje në Projektligj dhe Raportin me amendamente të Komisionit Funksional, Komisioni nxori këtë:

Rekomandim

- I. Komisioni për të Drejtat, Interesat e Komuniteteve dhe Kthim, ka shqyrtuar Projektligjin nr. 05/L-101 për performancën energjetike në ndërtesa dhe konstatoi se projektligji nuk cenon dhe nuk prek të drejtat dhe interesat e komuniteteve dhe i njëjti mund të procedohet për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare të Kuvendit.

Mbledhja përfundoi në orën 12:30

E përgatiti:

Njësia për mbështetjen e Komisionit

Zëvendëskryetar i Komisionit

Agim Çeku